



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Raport përmbledhës i rezultateve të vlerësimit nga pyetësi
"Vetëvlerësimi i Stafit Akademik"

Viti akademik 2024/25

1. Qëllimi i vlerësimit

Pyetësi i vetëvlerësimit të stafit akademik ka për qëllim mbledhjen e informatave të detajuara mbi performancën, angazhimin, sfidat dhe zhvillimin profesional të stafit akademik, në mënyrë që të identifikojmë fushat potenciale për përmirësimin dhe zhvillimin e stafit akademik.

2. Metodologjia e punës

Ashtu siç është e paraparë në Kalendarin e aktiviteteve të sigurimit të cilësisë, është realizuar procesi i Vetëvlerësimit të Stafit Akademik, për vitin akademik 2024/2025. Procesi i Vetëvlerësimit në Fakultetin e Biznesit; Fakultetin e Menaxhimit në Turizëm, Hotelieri dhe Mjedis; Fakultetin Juridik; Fakultetin e Agrobiznesit; Fakultetin e Arteve, ka filluar me datë 21 maj 2025 dhe ka zgjatur deri me 06 qershor 2025. Gjatë kësaj periudhe, stafi akademik kanë pasur mundësinë të plotësojnë pyetësin “Vetëvlerësimi i Stafit Akademik”, i cili ju është paraqitur në formë elektronike përmes Sistemit SEVC.

Pyetësi i vetëvlerësimit të stafit akademik përmban gjithsej **9 pyetje**, prej të cilave **5** janë me mundësi **përgjigje alternative**, ku të anketuarit zgjedhin një opsion të caktuar nga një listë përgjigjesh të paracaktuara (*nuk pajtohem aspak, nuk pajtohem, neutral, pajtohem, pajtohem plotësisht*), që matin perceptimin dhe qëndrimet e stafit ndaj ngarkesës së punës, cilësisë së mësimdhënies dhe përfshirjes në aktivitete akademike, ndërsa **4** janë pyetje të hapura që synojnë mbledhjen e informatave cilësore lidhur me aktivitetet, metodat e përdorura, sfidat dhe komentet e përgjithshme për përmirësimin e punës akademike. Pyetësi është plotësuar nga gjithsej 65 profesor/asistent në nivel universiteti.

3. Procesi i vlerësimit

Procesi i vlerësimit përmes pyetësit “Vetëvlerësimi i Stafit Akademik”, sikurse format e tjera të vlerësimit, menaxhohet nga Zyra Qendrore për Sigurim të Cilësisë dhe Vlerësim në UHZ, në bashkëpunim me Koordinatorët dhe Zyrtarët e Cilësisë të njësive akademike. Me fillimin e procesit, stafi akademik është njoftuar nga Zyra për sigurim të cilësisë dhe vlerësim, përmes e-mailit se pyetësi është në dispozicion për plotësim përmes sistemit SEVC. Pas përfundimit të periudhës së caktuar për plotësim të pyetësit, Zyra për sigurim të cilësisë dhe vlerësim ka grumbulluar, përpunuar dhe analizuar të dhënat nga ky proces dhe ka hartuar raportin përmbledhës. Mbi bazën e rezultateve, Këshilli për Menaxhim të Cilësisë dhe Vlerësim ka dhënë rekomandime për përmirësim.

4. Rezultatet e vlerësimit

Në pyetjen: **Ngarkesa ime e punës është ne pajtueshmëri me planin individual?**

46% e stafit (30 persona) kanë deklaruar se **“pajtohen plotësisht”** që ngarkesa e tyre e punës është në pajtueshmëri me planin individual, që tregon se pothuajse gjysma e stafit ndjehet plotësisht e kënaqur me balancën ndërmjet ngarkesës së punës dhe planifikimit individual. **45% e stafit (29 persona)** kanë thënë se **“pajtohen”**, çka përforcon perceptimin pozitiv dhe tregon se shumica e stafit e vlerëson ngarkesën e punës si të përshtatshme dhe në harmoni me planin e tyre individual. **5% e stafit (3 persona)** janë **“neutral”**, që mund të nënkuptojë se ata nuk kanë pasur një përvojë të qartë pozitive apo negative, ose nuk kanë qenë të sigurt për përputhjen e plotë mes planit dhe ngarkesës reale të punës. **3% e stafit (2 persona)** kanë deklaruar se **“nuk pajtohen”**, ndërsa **1% e stafit (1 person)** ka theksuar se **“nuk pajtohet aspak”**, duke sinjalizuar se për një numër shumë të vogël mund të ketë mospërputhje midis detyrave të planifikuara dhe atyre të realizuara (figura 1).




Figura 1

Në pyetjen: **Unë arrij që ta përcjellë në mënyrë të saktë qëllimin, objektivat dhe pritjet mësimore të planprogramit?**

Pjesa më e madhe e stafit, 72 % (47 persona) **“pajtohen plotësisht”** që arrijnë të përcjellin në mënyrë të saktë qëllimin, objektivat dhe pritjet mësimore të planprogramit. Kjo reflekton një nivel të lartë profesionalizmi dhe zotërim të praktikave të mira mësimore. Një përqindje e konsiderueshme e stafit, **26% (17 persona)** është gjithashtu pozitive **“pajtohen”**. Kjo tregon se shumica arrijnë ta realizojnë këtë aspekt në mënyrë të mirë, megjithatë mund të ndiejnë nevojë për përmirësim të mëtejshëm në aspektin e komunikimit ose qartësisë së objektivave. Për opsionin **“neutral”** dhe **“nuk pajtohem”** nuk është deklaruar askush. Ndërsa, vetëm një pjesëmarrës ka shprehur mospajtim të plotë, që mund të jetë rast individual i ndikuar nga përvoja, fusha e studimit, ose nga mungesa e mbështetjes në planifikim të mësimi (figura 2).




Figura 2

Në pyetjen: **Unë menaxhoj me lehtësi në mënyrë kontinuale vlerësimet në lidhje me mësimnxënien dhe ato janë pjesë e notës përfundimtare?**

Shumica e pjesëmarrësve, 64.6% (42 persona) **“pajtohen plotësisht”** se menaxhojnë me lehtësi procesin e vlerësimeve të vazhdueshme dhe i përfshijnë ato në notën përfundimtare. Ky rezultat tregon nivel të lartë profesionalizmi, përgatitjeje dhe përvojë në zbatimin e praktikave të rregullta të vlerësimit. Një pjesë e konsiderueshme e stafit, 32.3% (21 persona) **“pajtohen”**, duke reflektuar njohuri dhe aftësi të qëndrueshme në menaxhimin e vlerësimeve, edhe pse mund të ketë hapësirë për përmirësim në aspektin e lehtësisë ose konsistencës së zbatimit. Një pjesëmarrës ka mbetur neutral, gjë që mund të nënkuptojë se nuk ka një qëndrim të qartë. Një pjesëmarrës ka deklaruar se ka vështirësi në menaxhimin e vlerësimeve të vazhdueshme, duke sinjalizuar mundësi për mbështetje individuale ose përfshirje në trajnime për zhvillim profesional (figura 3).




Figura 3

Në pyetjen: **Ne aktivitetet hulumtuese/artistike i përfshijë edhe studentët?**

Një numër i konsiderueshëm i stafit, 32% (21 persona) **“pajtohen plotësisht”** se studentët përfshihen në mënyrë të plotë në aktivitetet hulumtuese/artistike. Kjo tregon angazhim të mirëfilltë të mësimeve në përfshirjen e studentëve në proceset kërkimore dhe krijuese. 51% (33 persona) kanë vlerësuar me **“pajtohem”** që tregon se shumica e stafit pajtohen se studentët janë të përfshirë në aktivitete të tilla, por ndoshta jo në mënyrë të vazhdueshme apo të thelluar. Një pjesë e vogël e stafit, 17% (11 persona) mbeten të paanshëm **“neutral”**, gjë që mund të nënkuptojë se nuk kanë qenë të përfshirë personalisht në aktivitete të tilla (figura 4).




Figura 4

Në pyetjen: **Unë marrë pjesë në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse të njësisë akademike/universitetit?**

Një numër i konsiderueshëm i të anketuarve, 23.1% (15 persona) shprehin përfshirje të plotë dhe të rregullt në vendimmarrje **“pajtohen plotësisht”**. Ky grup përfaqëson individë që ndoshta kanë rol aktiv në këshilla, komisione apo organe vendimmarrëse, duke ndjerë ndikim real në proceset institucionale. Pjesa më e madhe e të anketuarve, 38.5% (25 persona) **“pajtohen”** se marrin pjesë në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse të njësisë apo universitetit. Kjo tregon se shumica ndjehen të përfshirë në strukturat dhe aktivitetet ku merren vendime të rëndësishme, çka reflekton një kulturë të mirë bashkëpunimi dhe përfshirjeje. Një pjesë e stafit kanë qëndrim **“neutral”**, 23.1% (15 persona), çka mund të nënkuptojë se ata nuk kanë pasur eksperiencë të drejtpërdrejtë me proceset vendimmarrëse. Një numër i vogël i të anketuarve, 7.7% (5 persona) **“nuk pajtohen”**, duke treguar se nuk ndihen të përfshirë në proceset politikëbërëse apo vendimmarrëse. Kategoria me vlerësimin më të ulët, 7.7% (5 persona) **“nuk pajtohen aspak”** dhe ky rezultat sinjalizon nevojën që njësia apo universiteti të analizojë arsyet pse këta persona ndihen të përjashtuar dhe të ndërmarrë hapa për përfshirje më të gjerë (figura 5).




Figura 5

Në pyetjen: **Aktiviteti im në punime shkencore/artistike, konferenca dhe aktivitete tjera që kontribuojnë në fushën akademike gjatë vitit akademik 2023/2024, ka qenë:**

Rezultatet tregojnë një vit jashtëzakonisht aktiv, me një nivel të lartë produktiviteti dhe përfshirjeje në fusha të ndryshme akademike dhe artistike. 65 staf akademik të cilët kanë plotësuar pyetësin janë deklaruar se: Gjatë vitit akademik 2024/25 kanë publikuar **51 punime shkencore**; **Pjesëmarrje në 41 Konferenca shkencore ndërkombëtare**; **Pjesëmarrje në 30 projekte kërkimore**; **Pjesëmarrja në 7 koncerte**; **Pjesëmarrja në 44 trajnime, punëtori, seminare, etj.**




Figura 6

REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIM NGA KËSHILLI PËR MENAXHIM TË CILËSISË DHE VLERËSIM

- Rekomandohet Biblioteka e Universitetit të ndërmarrë hapa për sigurimin e të paktën një marrëveshjeje vjetore për qasje në një bazë të njohur ndërkombëtare të të dhënave.
Afati kohor i implementimit: brenda vitit akademik 2025/26.
- Rekomandohen mësimdhënësit të cilët deri me tani nuk kanë përfshirë studentët në hulumtime, që të përfshijnë minimumi 1 student në të paktën një aktivitet hulumtues/artistik gjatë vitit akademik 2025/26.
Afati kohor i implementimit: viti akademik 2025/26!
- Rekomandohet menaxhmenti i universitetit të zgjerojë kapacitetet hapësinore, me qëllim të sigurimit të zyrave/kabineteve adekuate për të gjithë stafin.
Afati kohor i implementimit: tetor 2027!
- Rekomandohet menaxhmenti i universitetit të hartojë një politikë institucionale për rritjen e pjesëmarrjes së rregullt të studentëve në ligjërata, duke përfshirë masa stimuluese, mekanizma monitorimi dhe aktivitete të integruara mësimore.
Afati kohor i implementimit: semestri veror 2025/26.
- Rekomandohet Qendra e Ekselencës të organizojë të paktën 1 trajnim vjetor për metodat bashkëkohore të mësimdhënies dhe mësimnxënies, duke siguruar gjithëpërfshirje të stafit.
Afati kohor i implementimit: brenda vitit akademik 2025/26.
- Rekomandohet Qendra e Ekselencës të sigurojë një trajnim të avancuar në vit në metodologjinë e kërkimit shkencor, duke siguruar gjithëpërfshirje të stafit.
Afati kohor i implementimit: brenda vitit akademik 2025/26.
- Rekomandohet menaxhmenti të planifikojë dhe realizojë **zgjerimin hapësirave laboratorike.**
Afati kohor i implementimit: tetor 2029!
- Rekomandohet Fakulteti i Agrobiznesit të përgatisë një listë të nevojave dhe të sigurojë reagenca dhe pajisjeve për garantimin e zhvillimit të plotë të ushtrimeve laboratorike.
Afati kohor i implementimit: brenda vitit akademik 2025/26.